

VENDIM

Nr. 831, datë 28.12.1998

PËR MËNYRËN E DHËNIES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, PASURI SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore” dhe të ligjit nr. 8406, datë 17.9.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore””, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Përcaktimi, vlerësimi dhe përparësia e sipërfaqes së tokës bujqësore, pasuri shtetërore, që jepet me qira dhe miratimi i studimeve.

1. Drejtoria e bujqësisë dhe ushqimit në rreth bën studimin për tokat bujqësore, të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme si pasuri shtetërore dhe që jepen me qira, në rrethin ku ajo shtrin juridiksionin.

Në studim përfshihen:

- a) Sipërfaqja e tokës bujqësore, pasuri shtetërore, që jepet me qira.
- b) Treguesit teknikë për sipërfaqet e tokës bujqësore.
- c) Treguesit për prodhimin dhe të ardhurat për njësi sipërfaqe në mesataren e zonës, që parashikohet të jepet tokë bujqësore, pasuri shtetërore, me qira.
- ç) Propozimet për vlerën fillestare të ankandit.
- d) Propozimet për afatin kohor të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, për zona të caktuara.
- e) Propozimet për qëllimet e qiradhënies.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit shqyrton dhe miraton studimet e paraqitura nga drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në rrethe.

II. Ngritja dhe funksionimi i bordit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore.

1. Bordi i dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, përbëhet nga nëntë anëtarë, me specialistë të drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit dhe të seksioneve të urbanistikës, të kadastrës, të mjedisit dhe jurist. Anëtarë të bordit janë: Drejtori i drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit të rrethit, një agronom, një ekonomist dhe një specialist i blegtorisë së drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit në rreth, specialist i mjedisit, specialist i kadastrës, specialist i

urbanistikës, jurist i këshillit të rrethit (bashkisë), specialisti i komunës, në të cilën ndodhet toka, që do të jepet me qira.

2. Kryetari i bordit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, të jetë drejtori i drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit në rreth. Krijimi i bordit bëhet me urdhër të

ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

3. Kryetari i bordit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, emërohet dhe shkarkohet nga ky funksion nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Bordi për dhënien me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, zbaton udhëzimin “Për procedurën e zhvillimit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore”.

5. Bordi i dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, përcakton fituesin dhe ia paraqet për miratim ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit. Pas miratimit nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, bordi shpall fituesin dhe drejtorja e bujqësisë dhe ushqimit e rrethit lidh kontratën përkatëse.

6. Vlera e qirasë e përcaktuar në kontratë, për çdo vit indekskohet në përputhje me të dhënat e fillimit të vitit, të treguesve makroekonomikë, të publikuar nga organi shtetëror i autorizuar (INSTAT).

III. Mënyra e pagesës së vlerës së qirasë

1. Të ardhurat financiare, që sigurohen nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pasuri shtetërore, arkëtohen për llogari të buxhetit të shtetit.

2. Vjelja e të ardhurave financiare bëhet 25 për qind të vlerës vjetore, në fund të çdo tremujori.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko